



REPUBLIKA SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
Keshilli I Basenit Ujembledhes Mat

V E N D I M

Nr.21 Date 09.11.2011

Per

Miratim te Lejes se Perdorimit te ujit per nevoja teknologjike subjekti “Vllaznimi -Deda” shpk Preng Zefi, burimi uhor Liceni Sopajve, sipas kerkeses se ketij subjekti:

- Ne mbeshtetje te nenit 8 pika 1, neni 18 te ligjit nr.8093 dt. 21.03.1996 “Per Rezervat Ujore”, te Vendimit K.M. Nr. 27 date 19.01.2007, “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve, Kreu XI, pika 9, me propozim te A.U.B. Mat per paisjen me leje Perdorimi te Rezerves Ujore shoqerise “Vllaznimi-Deda”shpk, sipas kerkeses date 02/10/2011 , **Keshilli i Basenit Mat,**

VENDOSI:

1- **Shtyrjen e miratimit te kerkeses se Zotit Preng Zefi, administrator i “Vllaznimi-Deda” shpk** per dhenie Leje Perdorim Rezerva Ujore per larje mineralesh deri sa te konkludohet ne se marrja e ketij uji perben apo jo konflikt me perdoruesit e ujit te Licenit Sopes. Nga verifikimi ne vend rezultoi se kjo leje nuk perben konflikt me perdoruesit e ujit per energji ne skemen energjitike te Perroit Licone. Kerkesa per Leje Perdorimi uji per nevoja teknologjike permban keto te dhena:

- Subjektit juridik/fizik: “Vllaznimi-Deda”
- Prurja mesatare : $Q=4,5$ lit/sek,
- Kuota e vepres se marrjes 1760 m,
- Kuota e impiantit 1550m.

2- Personi fizik/juridik “Vllaznimi-Deda”shpk me administrator zoti Preng Zefi eshte e vlefshme ne se nuk demton interesat e komunitetit per perdorim uji per nevoja per vaditje, per uje te pijshem, e tjere perdorime te rezervave ujore sipas ligjit.Keto jane arsye qe perbejne shkak anulimin e kesaj leje ne menyre te menjehershme.

3- Ky vendim hyn ne fuqi mbasi te shprehet Drejtoria Teknike ne MMPAUjrave Tirane, duke plotesuar te gjithë kerkesat e ligjshme nga Bordi Kullimit dhe nga Pushteti Vendor.

PERGJEGJESI I A.U.B. MAT
Pashk NDOCI

KRYETARI I K.B.U. MAT
Pal DAJCI